



Këshilli i Sigurimit

Distr.: I
përgjithshëm
24 korrik 2017

Originali: Anglisht

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit

1. Ky raport paraqitet në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999), përmes së cilës Këshilli vendosi të themelojë Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi që unë të raportoj në intervale të rregullta për implementimin e mandatit të tij. Raporti mbulon aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet që lidhen me të nga 16 prill deri më 15 korrik 2017.

2. Prioritetet e Misionit vazhdojnë të jenë promovimi i sigurisë, i stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në rajon. Për avancimin e objektivave të tij, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe me Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me akterët regionalë e ndërkombëtarë. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë të luajnë rolet e tyre brenda kornizës së Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon praninë e tij në Kosovë në pajtim me deklaratën presidenciale të Këshillit të Sigurimit të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin tim të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara punojnë ngushtë me këtë Mision.

II. Zhvillimet politike dhe të sigurisë

3. Kjo periudhë raportuese është shënuar me rënien e qeverisë së koalicionit, të udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, që më pas ka rezultuar me zgjedhje të parakohshme parlamentare. Qeveria ra pas votimit në Kuvendin e Kosovës më datën 10 maj për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë, të parashtruar nga atëbotë partia në opozitë, Nisma për Kosovë. Ky mocion u miratua me 78 vota për, ku për miratim të tij ndër të tjera ishin edhe 34 nga 36 deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës në pozitë. Si rezultat i këtij votimi, Kuvendi u shpërbë dhe u caktuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare për datën 11 qershor.

4. Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhje, më datën 31 maj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikoi listën përfundimtare të votuesve, e cila përbëhej nga 1,872,941 votues me të drejtë vote, duke përfshirë edhe 155,202 votues të ri për herë të parë. Komisioni gjithashtu dha njoftimin se gjithsej do të jenë 889 qendra të votimit, të përbëra nga 2,490 vendvotime. Pas ftesës së kryetarit të Kosovës, Hashim Thaçi,



më datën 30 maj Bashkimi Evropian dha njoftimin lidhur me ardhjen e misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve në Kosovë.

5. Periudha 10-ditore e fushatës zgjedhore filloi më 31 maj. Për 120 ulëse në Kuvendin e Kosovës hynë në garë 26 subjekte politike, të cilat përbëheshin nga pesë koalicione parazgjedhore, 19 parti politike dhe dy nisma qytetare. Pas negociatave intensive, Partia Demokratike e Kosovës themeloi koalicionin parazgjedhor me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Nismën për Kosovën dhe me dhjetë parti të tjera të vogla politike të shqiptarëve të Kosovës në një grupim të të gjitha partive kryesore që kanë dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës brenda një entiteti zgjedhor. Koalicioni emërojë udhëheqësin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, si kandidatën e tij për kryeministër. Lidhja Demokratike e Kosovës formoi koalicionin parazgjedhor, duke emëruar si kandidat të tij. Vetëvendosje ishte e vetmja parti e madhe e shqiptarëve të Kosovës që vendosi të mos hynte në koalicion parazgjedhor. Vetëvendosje nominoi ish-liderin e partisë, Albin Kurtin, si kandidat për kryeministër.

6. Gjatë periudhës parazgjedhore u bë edhe rikonfigurimi i ambientit politik të serbëve të Kosovës përmes transformimit të grupit politik Iniciativa Qytetare Lista Serbe (Gradjanska Inicijativa Srpska Lista) në parti politike, e cila publikisht është përkrahur nga përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë. Po ashtu, një numër i politikanëve serbë të Kosovës që më parë ishin anëtarë të Iniciativës Qytetare Lista Serbe vendosen të dalin në zgjedhje me lista të veta, gjë që i kontribuoi një periudhe relativisht të tensionuar të fushatës, ku pretendohet se ka pasur edhe kërcënime dhe incidente të sigurisë të motivuara politikisht. Më 5 qershor, shefi i misionit të Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve kritikoi ambientin zgjedhor dhe ftoi policinë dhe prokurorët që të hetojnë në mënyrë të shpejtë dhe strikte të gjitha incidentet e tilla. Në gjetjet e tij preliminarë të datës 13 qershor, misioni vëzhgues theksoi se ambienti zgjedhor në komunat e Kosovës me shumicë serbe “ka qenë i njollësor me kërcënime dhe me raste të dhunës brendapërbrenda komunitetit serb të Kosovës të drejtuar kundër kandidatëve dhe votuesve”.

7. Vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve erdhën në përfundim se zgjedhjet parlamentare të datës 11 qershor janë mbajtur pa incidente apo parregullësi të mëdha, përveç incidenteve të lartpërmendura të lokalizuara që kishin të bënin me ngacmimin e votuesve, si dhe problemeve tanimë afatgjata dhe të pazgjidhura lidhur me listat e votuesve dhe pjesëmarrjen e plotë të votuesve jashtë Kosovës. Shefi i misionit vëzhgues gjatë paraqitjes së gjetjeve preliminarë, i vlerësoi zgjedhjet e 11 qershorit në Kosovë si “të mirëfillta konkurruese dhe paqësore në shumicën e vendeve”. Kryetari i Kosovës i mirëpriti gjetjet preliminarë të misionit, të cilat sipas mendimit të tij “konfirmuan se zgjedhjet kanë qenë të lira, demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare”.

8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet e certifikuara më datën 8 korrik. Koalicioni i Partisë Demokratike të Kosovës, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Nismës për Kosovën dhe i të tjerëve kishte marrë 33.7 për qind të votave, duke siguruar kështu 39 ulëse në Kuvendin e Kosovës. Vetëvendosja kishte fituar 27.49 për qind të votave dhe 32 ulëse, ndërsa koalicioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Aleancës Kosova e Re dhe Alternativës kishte marrë 25.53 për qind të votave dhe 29 ulëse. Iniciativa Qytetare Lista Serbe kishte siguruar 9 nga 10 ulëset e garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës, ndërsa Partia e Pavarur Liberale kishte fituar ulësen e dhjetë. Përfaqësuesit politikë të komunitetit ashkali, boshnjak, goran, romë dhe të atij turk së bashku kanë zënë 10 ulëset e garantuara për komunitetet e tjera joshumicë. Asnjë parti apo koalicion parazgjedhor nuk ka siguruar shumicë absolute dhe deri në fund të periudhës raportuese asnjë aleancë paszgjedhore nuk është formuar për krijimin e qeverisë. Kuvendi duhet të mbajë mbledhjen e tij konstitutive jo më vonë se më 7 gusht.

9. Pas një takimi konsultativ me përfaqësuesit e partive politike dhe me Komisionin Qendror Zgjedhor, më 22 qershor, kryetari i Kosovës shpalli mbajtjen e zgjedhjeve

komunale në Kosovë për datën 22 tetor.

10. Gjatë periudhës nën shqyrtim kanë qenë evidente edhe disa tensione serioze. Më 5 maj, një shqiptar i ri i Kosovës është vrarë me armë zjarri në një bar në afërsi të urës kryesore në Mitrovicë të Jugut. Si reagim ndaj kësaj vrasjeje, më 7 maj, rreth 4000 persona protestuan në Mitrovicë të Jugut për të dënuar dhunën dhe për të kërkuar drejtësi. Gjithashtu, më 5 maj, rreth 100 aktivistë të Vetëvendosjes protestuan para Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë në kërkim të drejtësisë për Astrit Deharin, anëtarin e partisë së tyre, i cili kishte vdekur gjatë mbajtjes në arrest më datën 5 nëntor 2016. Protesta u përshkallëzua në dhunë, ku protestuesit hidhnin gurë drejt policëve të Policisë së Kosovës, duke lënduar dy prej tyre, dhe ku i vandalizuan deri në 60 automjete të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Policisë së Kosovës. Në një incident të ndarë, më 13 maj në Prishtinë, gazetarja e njohur e Kosovës, Arbana Xharra, morri lëndime të rënda gjatë një sulmi fizik nga persona të panjohur. znj. Xharra edhe më parë ka qenë cak i kërcënimeve dhe sulmeve për shkak të artikujve të saj lidhur me korrupsionin politik dhe rrezikun nga ekstremizmi fetar. Udhëheqësit vendorë dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare e dënuan sulmin dhe i ftuan autoritetet e zbatimit të ligjit që t'i sjellin fajtorët para drejtësisë.

11. Më 20 prill, Komisioni Zgjedhor i Republikës së Serbisë shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve presidenciale të atij vendi të mbajtura më 2 prill, përmes të cilave u konfirmua fitorja e ish-kryeministrit, Aleksandar Vuçiq, me 55,08 për qind të votave. Më 31 maj, z. Vuçiq u betua si president i ri i Serbisë në një sesion të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Serbisë. Qeveria e re e Serbisë është votuar nga Kuvendi më 29 qershor. Kryeministre e re është Ana Brnabić, ish-ministre e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale. Në udhëheqësinë e Zyrës për Kosovë e Metohi të Qeverisë së Serbisë nuk ka pasur ndryshime.

III. Veriu i Kosovës

12. Zgjedhjet e 11 qershorit shënuan daljen më të madhe të votuesve në komunat veriore që nga viti 1999. Në ditën e zgjedhjeve, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, OSBE-ja ofrojë ndihmesë teknike në të gjitha 44 qendrat e votimit në veri të Kosovës. Është me rëndësi të theksohet se zgjedhjet janë përkrahur publikisht nga Qeveria e Serbisë, ku më datën 21 maj, presidenti i sapozgjedhur i Serbisë, z. Vuçiq, personalisht inkurajoi serbët e Kosovës që të votojnë për Iniciativën Qytetare Lista Serbe.

13. Disa incidente gjatë periudhës raportuese kanë nxitur perceptimet për sundimin e dobët të ligjit, pandëshkueshmërinë dhe ndikimin e elementëve kriminale në veri të Kosovës. Një tentim për plaçkitje të armatosur të një automjeti të blinduar që transportonte para është raportuar më 17 maj afër Portës 1 të vendkalimit në vijën kufitare administrative. Gjatë këtij incidenti ka pasur edhe të shtëna armësh. Incidentet e tjera kanë qenë edhe sulmi i 29 majit me armë të zjarrit në objektin ku gjendet selia e Partisë së Serbëve të Kosovës në Leposaviq, dhe zënka me fjalë më 4 qershor në Leposaviq mes udhëheqësit të Partisë së Serbëve të Kosovës dhe përkrahësve të Iniciativës Qytetare Lista Serbe, gjatë së cilës Policia e Kosovës konfiskoi një armë. Më pas, më 5 qershor, vozitësi i kryetarit të Leposaviqit ishte sulmuar fizikisht gjatë një proteste të organizuar nga përkrahësit e Iniciativës Qytetare Lista Serbe para Qendrës për Mirëqenie Sociale në Leposaviq. Raportohet se incidenti ka ndodhur në afërsi të policëve të Policisë së Kosovës, të cilët më vonë raportuan që nuk kishin parë sulmin. Në një incident të ndarë më 26 qershor, katër persona të panjohur sulmuan tre shqiptarë të Kosovës në zonën e këmbësorëve në veri të Mitrovicës; viktimat ishin dërguar në spital në jug të Mitrovicës. Deri më sot askush nuk është ndjekur penalisht lidhur me këto raste.

14. Ura kryesore mes Mitrovicës së Veriut dhe të Jugut nuk është hapur për komunikacion rrugor. Pas një numri incidentesh të sigurisë publike në Mitrovicë të Veriut në mesin e prillit, duke përfshirë edhe disa incidente ndëretnike, kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut pezulloi punimet në pjesën veriore të urës dhe rreth saj, duke përfshirë edhe punimet në rrethrotullim që është pjesa kryesore e planeve të ndërtimit për

atë anë të urës. Për më tepër, kryetari i komunës kërkoi nga KFOR-i që të rrisë praninë në Mitrovicë dhe nga Policia e Kosovës që t'i intensifikoi kontrollet e sigurisë në zonat me popullsi etnikisht të përziera. Punët ndërtimore në urë rifilluan më 10 korrik.

IV. Marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Beogradit

15. Periudha raportuese ka pasur përparim të kufizuar në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Më 3 korrik, Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politika të sigurisë, Federica Mogherini, ishte nikoqire e një takimi joformal mes z. Vuçiq dhe z. Thaçi në Bruksel. Sipas komunikatës për shtyp të lëshuar nga Shërbimi Evropian për Punë të Jashtme, kryetarët Vuçiq dhe Thaçi u pajtuan “që të punojnë për fillimin e fazës së re të dialogut” dhe “theksuan rëndësinë e zbatimit të marrëveshjeve të arritura në dialog pa vonesa”.

16. Gjatë periudhës në shqyrtim, nuk është arritur përparim në zbatimin e marrëveshjes ekzistuese për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë të komunave me shumicë serbe apo në integrimin e gjyqësorit. Megjithatë, më 1 maj në përputhje me marrëveshjen për telekomunikacion, dy ofrues të shërbimeve telefonike të Serbisë, VIP dhe Telenor, ndalën punën e tyre në Kosovë. Dega e sapoformuar e Telekomit të Serbisë në Kosovë është autorizuar që të operojë në Kosovë, duke ofruar shërbime të telefonisë fikse dhe asaj mobile.

17. Më 27 prill, autoritete gjyqësore të Francës refuzuan kërkesën e Serbisë për ekstradimin e Ramush Haradinajt lidhur me fletarrestin e lëshuar për krimet që pretendohet të jenë kryer mes viteve 1998 dhe 1999. Qeveria e Serbisë ka parashtruar notë formale proteste tek ambasadori i Francës në Serbi. Në një adresim për publikun pas kthimit në Kosovë, z. Haradinaj e quajti kërkesën e Serbisë për ekstradim si “thirrje për luftë” dhe, duke iu referuar “armikut tonë, Serbisë”, kërcënoi se “do t’ua bëjmë shumë keq sesa që ua kemi bërë atëherë”.

18. Më 2 maj, Policia e Kosovës filloi zbatimin e urdhërësës, sipas së cilës pasaportat e Serbisë, të lëshuara nga Drejtoria për koordinim e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, e cila është përgjegjëse për lëshimin e pasaportave për serbët që jetojnë në Kosovë, më nuk vlejnë për udhëtim në Kosovë dhe prej saj. Gjatë periudhës raportuese, udhëtarët që përdornin këto pasaporta nuk kanë mundur të hynë apo të dalin nga Kosova. Ministrja për Dialog e Kosovës deklaroi më 2 maj se Drejtoria për koordinim është një strukturë ilegale dhe, rrjedhimisht, pasaportat e saj nuk njihen. Nga ana tjetër, autoritetet e Serbisë e kundërshtuan këtë, duke thënë se si një institucion qendror me seli në Beograd, Drejtoria për koordinim nuk mund të konsiderohet si një “institucion paralel” i Serbisë që vepron në Kosovë. Në kohën e raportimit, kufizimi i udhëtimit është ende në fuqi. Në praktikë, serbët e Kosovës që kërkojnë të marrin dokumentet personale të identitetit në Kosovë vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi administrative si rrjedhojë e kufizimeve të rrepta lidhur me pranueshmërinë e dokumenteve përcjellëse, posaçërisht, të dokumenteve civile të lëshuara nga institucionet e Serbisë.

19. Në një intervistë të datës 18 prill dhënë *Politico Europe* në Bruksel, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ngrii aspektin e bashkimeve regjionale në rast se nuk realizohen aspiratat për anëtarësim në Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit. Politikanët e tjerë në regjion shfrytëzuan mundësinë që ta fusin këtë qëndrim në kontekstin nacionalist. Në një intervistë me radion Evropa e Lirë më 19 prill, kryetari i Kosovës vuri në pah se të gjithë shqiptarët në regjion do të ishin të bashkuar në një hapësirë në rast se nuk përmbushen aspiratat e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Më pastaj, më 20 prill kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve të Serbisë deklaroi për agjencinë e lajmeve në gjuhën shqipe, Presheva Jonë, se Shqipëria dhe Kosova duhet t'i "tregojnë Serbisë dhe kjo është pjesë e Shqipërisë që nuk mund të preket", duke iu referuar komunave të përziera etnikisht në Serbinë e jugut. Më 5 maj, Qeveria e Serbisë ia dërgoi një dokument joformal përfaqësuesve të komunitetit diplomatik, duke protestuar "për legjitimizimin e projektit të Shqipërisë së Madhe".

V. Kthimet, pajtimi, marrëdhëniet mes komuniteteve dhe trashëgimia kulturore

20. Gjatë pjesës së parë të vitit 2017, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë ka regjistruar 218 kthime vullnetare individuale në Kosovë të anëtarëve të komuniteteve joshumicë, duke përfshirë 102 serbë dhe 104 anëtarë të komunitetit romë-ashkali-egjiptas. Sipas vlerësimeve të kësaj Zyre, deri në fund të qershorit, gjithsej numri i të kthyerve vullnetarë të anëtarëve të komuniteteve joshumicë që nga viti 2000 ishte 27,504. Gjithsej numri i personave të zhvendosur brenda vendit që jetojnë në Kosovë ishte 16,439, një zvogëlim ky prej 24 personash krahasuar me periudhën paraprahe raportuese.

21. UNMIK-u ka vazhduar angazhimin e tij me autoritetet komunale dhe me përfaqësuesit e komunitetit në përkrahje të përpjekjeve të tyre për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe për avancimin e pajtimit ndërkomunitar, ndërtimit të besimit dhe kthimeve. Përfaqësuesi im Special ka pasur diskutime me udhëheqësit komunalë dhe të komunitetit në 23 prej 38 komunave të Kosovës. Në kuadër të një strategjie më të gjerë në përkrahje të ndërtimit të besimit mes komuniteteve, UNMIK-u gjithashtu ka lehtësuar një numër aktivitetesh a me komitetet për bashkësi të komunave dhe me zyrat komunale për komunitete dhe kthim me qëllim të identifikimit të sfidave dhe masave të mundshme korrigjuese, si dhe të përmirësimit të komunikimit mes institucioneve komunale e qendrore.

22. Në përpjekje të rëndësishme për avancimin e pajtimit në Kosovë, më 19 maj më shumë se 250 të ri nga komuniteti shqiptar, ashkali, boshnjak, rom dhe serb të Kosovës kanë marrë pjesë në "marshin multietnik" të gjatë 16 km, i cili është organizuar në komunën e Obiliqit, me qëllim të sfidimit të paragjykimeve dhe të avancimit të dialogut.

23. UNMIK-u vazhdon me zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 2250 (2015) për ririnë, paqen dhe sigurinë. Më 28 dhe 29 qershor, UNMIK-u organizoi Asamblenë e parë të rinisë, të titulluar "Të avancojmë së bashku ririnë, paqen dhe sigurinë në Kosovë". Kjo ngjarje ku kanë marrë pjesë më shumë se 140 liderë të rinj (60 për qind femra dhe 40 për qind meshkuj) nga të gjitha komunitetet, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, të Bashkimit Evropian, të OSBE-së dhe të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i ka hapur rrugë angazhimit më të madh të rinisë në përkrahje të bashkëpunimit mes komuniteteve. Me këtë rast, pjesëmarrësit kanë diskutuar për shqetësimet, kanë këmbyer idetë dhe kanë dhënë rekomandimet për autoritetet vendore, Kombet e Bashkuara dhe palët e tjera me interes.

24. Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar së zbatuari Strategjinë e Kosovës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizimit që çon në terrorizëm 2015-2020. Disa komuna në bashkëpunim me organizatat vendore dhe ndërkombëtare janë angazhuar në mënyrë konstruktive me ririnë në përpjekje për ta parandaluar radikalizimin e të rinjve. Më 18 maj, në një konferencë të organizuar në Pejë nga organizata lokale

joqeveritare Këshilli për Veprim Rinor lidhur me temën angazhimi kundër ekstremizmit të dhunshëm, u trajtua rëndësia e tolerancës, bashkëjetesës së qetë dhe pjesëmarrjes më të madhe politike të rinisë dhe grave për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Në kuadër të një nisme tjetër gjithashtu të organizuar në maj, Drejtoria regjionale e Policisë së Kosovës në Ferizaj organizoi një numër fushatash të vetëdijesimit për pasojat e ekstremizmit dhe të radikalizimit fetar për nxënësit e shkollave të mesme.

25. Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur incidente të përdhosjes, duke përfshirë përdhosjen e dy gurëve të varrezave në varrezat ortodokse serbe në fshatin Vrbovc të komunës së Kllokotit më 5 maj dhe dëmtimin e kishës ortodokse serbe në fshatin Zallq të komunës së Istogut më 10 maj.

26. Autoritetet vendore në Deçan vazhduan të kundërshtojnë zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016, përmes të cilit u vendos në favor të manastirit të Deçanit në rastin e pronësisë së diskutueshme të tokës. Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian publikisht dënoi moszbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe i ftoj autoritetet e Kosovës “që të tregojnë respekt për sundimin e ligjit”. Autoritete komunale të Deçanit refuzuan të lejojnë regjistrimin e pronësisë në kadastrën komunale.

27. Organizatat e shoqërisë civile shprehën shqetësimin lidhur me shkeljen e Ligjit për zonat e posaçme të mbrojtura për qendrën historike të Prizrenit, gjë që pretendohet të pasqyron mangësitë në zbatimin e ligjit dhe neglizhencën e institucioneve komunale e qendrore. Nga 382 shtëpi të regjistruara në vitin 2006, vetëm 155 raportohet se janë mbetur të paprekura. Përveç kësaj, raportohet se vendet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë shndërruar në hotele dhe parkingje ilegale.

VI. Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit

28. Më 26 maj, zëdhënësi im lëshoi një deklaratë ku ritheksohej vlerësimi i lartë i Kombeve të Bashkuara për punën e vlefshme të Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, i cili shqyrtoj shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Në mesin e rasteve të shqyrtuara nga Paneli ishte edhe ankesa e parashtruar nga 138 individë të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptas përkitazi me helmimin nga plumbi dhe pasojat e tjera të rënda shëndetësore si rrjedhojë e vendosjes së tyre në kampet për personat e zhvendosur brenda vendit në veri të Kosovës. Në këtë drejtim, në deklaratën time të datës 26 maj, unë shpreha keqardhjen e thellë të Organizatës për vuajtjet e përjetuara nga të gjithë individët që kanë jetuar në kampe dhe shpalla vendimin tim që si një masë të jashtëzakonshme të themelohet një fond të mirëbesimit, përmes të cilit do të realizohen projektet e asistencës të bazuara në komunitet, kryesisht në Mitrovicën e Veriut dhe të Jugut, si dhe në Leposaviq, nga të cilat do të përfitojnë romët, ashkallitë dhe egjiptasit. Projektet e asistencës do të fokusohen në nevojat më urgjente të personave të cenueshëm, me theks në shërbimet shëndetësore, zhvillim ekonomik dhe infrastrukturë.

29. Përkrahja e kërkimit të personave të zhdukur mbetet prioritet themelor i punës së UNMIK-ut. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u përkrahu themelimin e Qendrës së Burimeve për Persona të Zhdukur në Prishtinë, një iniciativë kjo që bashkon shoqatat shqiptare dhe serbe të familjarëve të personave të zhdukur në përpjekje për t'i gjetur ata që ende mbesin të zhdukur dhe për të kërkuar punë më të mirë të politikanëve, institucioneve dhe bashkësisë ndërkombëtare në këtë drejtim. Po kështu, më 29 dhe 30 qershor, UNMIK dhe Zyra e Komisionerit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut, në konsultim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, organizuan një tryezë të rumbullakët në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë.

Tryeza e rrumbullakët që u hap me një fjalë rasti nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut dhe nga Përfaqësuesi im Special, i bashkoi anëtarët e delegacionit të Beogradit dhe atij të Prishtinës në Grupin punues për persona të zhdukur, përfaqësuesit e shoqatave të familjarëve të personave të zhdukur, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, anëtarët e Grupit punues për zhdukjet e dhunshme apo të pavullnetshme dhe anëtarin e Komisionit për personat e zhdukur në Qipro nga radhët e Kombeve të Bashkuara, të cilët kërkuan veprime vendimtare për zbardhjen e fatit të 1,658 personave që ende janë të zhdukur pas konfliktit në Kosovë. Pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët diskutuan për çështje specifike dhe identifikuan sfidat kryesore që duhet të trajtohen për të rigjallëruar Grupin punues për persona të zhdukur, rritur bashkëpunimin dhe përmirësuar rezultatet.

30. Në kuadër të angazhimit të Misionit me autoritetet komunale, duke përfshirë mekanizmat komunalë përgjegjës për mbrojtjen e komuniteteve joshumicë dhe grupet e cenueshme, është tërhequr vëmendja tek mospërputhshmëria sistematike me Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Disa institucione të Kosovës — në nivel qendror dhe lokal — ofrojnë shërbime në vetëm një gjuhë, qoftë ajo shqipe apo serbe. Sfidat kryesore vjen nga mungesa e përkthyesve të kualifikuar, ku kjo rezultoi me dokumente zyrtare që lëshohen pa pasur nevojë ligjrisht që të përkthehen. Kjo jo vetëm që shkakton vështirësi praktike, por edhe rrezikon përpjekjet për ndërtimin e besimit mes komuniteteve dhe mes individëve e institucioneve.

31. Më 21 dhe 22 qershor, UNMIK-u në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut, organizoi një ngjarje për këmbimin e njohurive në Prishtinë me qëllim të avancimit të të drejtave të njeriut, si dhe luftimit të terrorizimit e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo ngjarje kontribuoi në rritjen e njohurive dhe të kapacitetet operacionale të partnerëve nga shoqëria civile, institucioneve të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut gjatë procesit të parandalimit të terrorizimit.

32. Më 14 qershor, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës ngriti akuzë kundër nëntë individëve për vepra të ndërlidhura me terrorizimin lidhur me sulmet e planifikuara me rastin e ndeshjes ndërkombëtare të futbollit mes Izraelit dhe Shqipërisë në nëntor të vitit 2016. Ndaras nga kjo, është raportuar se komandanti i shqiptarëve të Kosovës që luftojnë për Shtetin Islamik në Irak dhe Levant (ISIS) është vrarë më 8 qershor gjatë luftimeve në Republikën Arabe të Sirisë.

33. Më 27 qershor, katër persona nga Kosova janë arrestuar në Klinë dhe janë akuzuar për trafikim të paligjshëm të armëve. Po ashtu, një i punësuar i Zyrës së Kosovës në Nju Jork është arrestuar dhe akuzuar për trafikim të armëve, trafikim të drogës dhe shpëlarje të parave lidhur me arrestimet në Klinë.

34. Në kuadër të hetimeve të vazhdueshme të Zyrës së Prokurorit Special të Kosovës, më 5 korrik, në një operacion të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe EULEX-it, janë arrestuar dy të dyshuar lidhur me vrasjen e një polici të UNMIK-ut dhe një polici të Kosovës, si dhe të tentimvrasjes të dy zyrtarëve të tjerë për zbatimin e ligjit në vitin 2004. Një i dyshuar tjetër është ekstraduar nga Gjermania.

35. Më 3 korrik, Gjykata Supreme e Kosovës liroi nga akuzat për krime të luftës ish-eprorin e lartë të ashtuquajturit Grupit të Drenicës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, anëtarin e njohur të Partisë Demokratike të Kosovës dhe kryetarin e komunës së Skenderajt, Sami Lushtakun. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i formës së prerë, dhe ndaj tij nuk mund të parashtrahet ankesa.

36. Më 28 qershor, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konfirmoi se rregullorja e ndryshuar e punës dhe e dëshmimeve e Dhomave të Specializuara të Kosovës që gjenden në Hagë është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij aktgjykimi, më 5 korrik dhomat u bënë funksionale dhe në gjendje që të pranojnë çfarëdo parashtrëse apo akuze nga Zyra e Prokurorit Special.

37. Komiteti ekzekutiv i Organizatës Ndërkombëtare të Policisë (INTERPOL) ka përfshirë kërkesën ekzistuese të Kosovës për anëtarësim në organizatë në agjendën preliminare të sesionit të 86-të të Asamblesë së Përgjithshme të Interpolit, e cila do të mbahet në shtator të vitit 2017. Në Asamble do të vendoset se a do të pranohet agjenda preliminare dhe a do të votohet kërkesën.

VII. Partneriteti dhe bashkëpunimi

38. UNMIK-u vazhdoi të lehtësojë ndërlidhjen mes autoriteteve të Kosovës dhe INTERPOL-it. Institucionet e Kosovës plotësisht kanë respektuar procedurat e dakorduara për ndërlidhje me INTERPOL-in përmes UNMIK-ut. Gjatë periudhës raportuese, UNMIK-u ka pranuar 28 kërkesa për lëshimin e fletarresteve ndërkombëtare dhe janë publikuar 13 fletarresteve të kuqe. UNMIK-u gjithashtu vazhdoi me ofrimin e shërbimeve të vërtetimit të dokumenteve. Kështu, gjithsej janë përpunuar 398 dokumente, ku 243 kanë pasur të bëjnë me pensionet, për Republikën e Serbisë, dhe 155 për gjendjen civile, siç janë dokumentet e shkollave të mesme, diploma universitare, si dhe certifikata të martesës, të lindjes dhe të vdekjes.

39. Përfaqësuesi im Special ka mbajtur koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë në Kosovë, duke përfshirë komandantin e KFOR-it, Përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian, shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, shefin e EULEX-it dhe Shefin e Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë.

40. Në maj, entiteti i Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe fuqizim të grave së bashku me Zyrën e Prokurorit Special, organizuan një takim ekspertësh për dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin dhe u dhanë këshillime të bazuara në raste gjyqësore prokurorëve dhe hetuesve vendorë të krimeve të luftës. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë përkrahu Zyrën e Avokatit të Popullit në themelimin e një platforme në internet, të quajtur “Mësoji të drejtat e tua”. Kjo platformë është e paraparë për shkolla, komunitete, të rinj dhe familje me qëllim të raportimit të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut. Më 28 qershor, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar botuan edicionin e posaçëm të anketës së perceptimit publik të quajtur “Pulsi publik”, me fokus në rritjen e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Në këtë anketë nënvizohen sistemi i dobët i arsimit, kriza e identitetit dhe ndjenja e përgjithshme e izolimit si nxitës të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë.

VIII. Vrojtime

41. Dëshiroj t’i përgëzoj përpjekjet e institucioneve të Kosovës, të vëzhguesve vendorë e ndërkombëtarë, të ofruesve të sigurisë dhe të votuesve për realizimin e suksesshëm të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë. I ftoj ata që do ta formojnë qeverinë e re të Kosovës që të qeverisin në mënyrë të përgjegjshme dhe së bashku me opozitën të punojnë në mënyrë konstruktive, si dhe të promovojnë transparencën e llogaridhënien. Është me rëndësi jetike për administratën e re që të gjejë pajtimin për realizimin e prioriteteve ekzistuese të politikave dhe të punoj së bashku në mënyrë të përgjegjshme me qëllim të tejkalimit të sfidave të konsiderueshme që gjenden përpara, si dhe të shfrytëzimit të shumë mundësive që ekzistojnë në Kosovë.

42. Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit ballafaqohet me sfida serioze. Së këndejmi, dëshiroj të inkurajoi përkushtim ndaj parimit që mospajtimet duhet të zgjidhen vetëm përmes mjeteve paqësore. I ftoj të dyja palët që të riangazhohen në dialog dhe që ta ringjallërojnë procesin. I vlerësoj lartë përpjekjet e Bashkimit Evropian për ruajtjen e angazhimit mes Beogradit dhe Prishtinës në periudhën raportuese, gjatë së cilës ka pasur ndërprerje si për administratën e Serbisë, ashtu edhe për atë të Kosovës.

43. Fillimi i periudhës raportuese është shënuar me incidente të retorikës luftënxitëse.

Unë i ftoj liderët politikë në Kosovë dhe regjion që të përmbahen nga deklaratat dhe veprimet që nxisin nacionalizëm dhe përçarje. Po ashtu, e inkurajoi qeverinë e re në Beograd dhe atë në Prishtinë që t'i japin shtytje angazhimit konstruktiv për trajtimin e çështjeve të pazgjidhura në një atmosferë pozitive.

44. Sundimi i ligjit, dhe zbatimi i tij i paanshëm janë themele të çdo shoqërie demokratike. Andaj, inkurajoj përpjekje më të mëdha në konsolidimin e sundimit të ligjit në Kosovë, posaçërisht lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të grupeve të cenueshme dhe të trashëgimisë kulturore. Gatishmëria operationale e Dhomave të Specializuara të Kosovës është një zhvillim pozitiv për drejtësinë dhe pajtimin. Së këndejmi, është e rëndësishme thelbësore që këtij institucioni t'i ofrohet bashkëpunim i plotë i të gjitha palëve dhe që të mos pengohet në zbatimin e efektshëm të detyrave të tij.

45. Mirëpres ngjarjen e përbashkët të organizuar nga UNMIK-u dhe Zyra e Komisionarit të lartë të Kombeve të Bashkuara përkitazi me rritjen e vetëdijesimit për persona të zhdukur dhe asistencën për trajtimin e kësaj çështjeje. Ftoj udhëheqësit politikë, institucionet dhe bashkësinë ndërkombëtare që të tregojnë përkushtimin e tyre në realizimin e këtij prioriteti dhe në sjelljen e paqes atyre që kanë vuajtur.

46. Çmtoj gjithashtu angazhimin e Misionit me pushtetin lokal dhe komunitetet, në veçanti bashkëpunimin konstruktiv të Përfaqësuesit tim Special me administratat komunale, duke përfshirë edhe bashkëpunimin lidhur me mbrojtjen dhe mirëqenien e komuniteteve joshumicë dhe grupeve të cenueshme. Me këtë rast dua të theksoj dhe të shpreh vlerësimin tim të lartë për mbajtjen e Asamblesë së parë të rinisë së Kosovës, ku u bashkuan të rinjtë nga komunitetet e mbarë Kosovës për të planifikuar së bashku një të ardhme më të ndritshme dhe për të treguar që dëshira për pajtim është e pranishme në shoqërinë e Kosovës. Nismat e cekura në këtë raport janë pjesë e strategjisë së UNMIK-ut për nxitjen e pajtimit shoqëror, të cilën plotësisht e përkrahi si një aspekt thelbësor për zbatimin e mandatit të Misionit në promovimin e paqes dhe stabilitetit.

47. I ftoj shtetet anëtare që të përkrahin fondin e mirëbesimit, të themeluar pas rekomandimeve të Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut. Përkrahja e tyre zemërgjerë do të shkojë drejt trajtimit të nevojave më urgjente të komuniteteve të prekura.

48. Falënderoj Përfaqësuesin tim Special për angazhimin e tij me udhëheqësit e Prishtinës dhe Beogradit, udhëheqësit lokalë dhe komunitetet, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe me partnerët në bashkësinë ndërkombëtare. Kapacitetet e UNMIK-ut janë në shërbim të të gjitha palëve që kërkojnë të japin kontribut pozitiv drejt paqes dhe sigurisë në Kosovë.

49. Dëshiroj të përfundoj duke ritheksuar falënderimin tim për partnerët afatgjatë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke përfshirë KFOR-in, Bashkimin Evropian dhe OSBE-në, si dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara për punën e tyre të shkëlqyeshme dhe bashkëpunimin me UNMIK-un.

Shtojca

I

Raport i Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të jashtme dhe Politika të Sigurisë për Sekretarin e Përgjithshëm lidhur me aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit për periudhën prej 16 prill deri më 15 korrik 2017

1. Përmbledhje

Policia e Kosovës ka shënuar përmirësime të mëtutjeshme në aftësitë e saj teknike, duke vepruar gjithnjë e më shumë si e pavarur dhe pa nevojë për këshilla dhe duke kërkuar kryesisht përkrahje strategjike në fusha të caktuara, siç mund të shihet edhe në përmirësimet e vazhdueshme dhe të përvitshme operacionale të Policisë së Kosovës gjatë festimit të përvjetorit të Ditës së Vidovdanit, që ka kulmuar edhe me performancën profesionale të këtij viti.

Trajtimi preferencial i të burgosurve të profilit të lartë lidhur me caktimin e kushteve të burgut për ta mbetet çështje shqetësuese.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka shënuar përparim në hetimet rreth një numri rastesh dhe ka vazhduar përpjekjet në përfundimin e rasteve që janë në faza të ndryshme të procedurave gjyqësore.

2. Aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

2.1 Përmbledhje e përgjithshme

Krimet e luftës

Gjatë periudhës raportuese janë ngritur tri aktakuza në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër të pandehurit të ekstraduar nga Mali i Zi, i cili dyshohet se ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile.

Më 26 prill, procedurat gjyqësore për krime të luftës kundër të akuzuarit në Gjykatën Themelore të Mitrovicës janë shtyrë pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, përmes së cilit urdhërohej rigjykimi. Më 21 prill, një panel i gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës liroi të akuzuarin nga burgu shtëpiak, por kërkoi nga ai që të lajmërohej dy herë në javë në stacionin policor në veri të Mitrovicës.

Më 12 maj, në rastin *Kleçka*, paneli i përbërë prej një gjykatësi vendor dhe dy gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën Supreme refuzoi si të pabazë kërkesën e prokurorëve të EULEX-it për mbrojtje të ligjshmërisë, që në fakt do të thotë lirim i të gjithë individëve të akuzuar në këtë rast penal të krimeve të luftës të profilit të lartë.

Më 3 korrik, një panel i përbërë prej një gjykatësi vendor dhe dy gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën Supreme miratoi ankesën e një të akuzuari në rastin e krimeve të luftës *Drenica I* dhe e liroi atë nga paraburgimi me kusht.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni

Më 5 maj, një panel i gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës shpalli aktgjykimin kundër të pandehurit në rastin lidhur me incidentin e të shtënave në kafeterinë e Mitrovicës së Veriut në vitin 2015, ku mbetën tre persona të lënduar. I pandehuri ishte liruar nga akuzat e lëndimit të lehtë trupor dhe të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm, por është dënuar për pronësi, kontroll dhe posedim të palejuar të armëve. Paneli i dha të pandehurit dënim me kusht në kohëzgjatje prej një viti, me periudhë të verifikimit prej tri vitesh.

Më 1 qershor, një panel i përbërë nga një gjyqtar vendor dhe dy gjyqtarë të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Prishtinës nxori një aktvendim, përmes të cilit u vazhdua mbajtja në arrest edhe për dy muaj kundër të pandehurit që akuzohet, në mes të tjerash, për krim të organizuar dhe vrasje të rëndë. Më 9 qershor, një panel i përbërë prej një gjyqtari vendor dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Apelit shpalli aktgjykimin, përmes të cilit urdhërohej që i padituri të lirohet me kaucion prej 2 milionë euro, të cilat duhet të derdheshin në para të gatshme në xhirollogarinë e Gjykatës apo në formë të hipotekës me

pronë të paluajtshme për shumën e kaucionit. Më 28 qershor i padituri është lëshuar me kaucion.

Krimet e tjera të rënda

Më 5 korrik, rreth 100 policë të Kosovës, së bashku me 35 policë të EULEX-it, realizuan një operacion të bastisjes dhe arrestimit në kuadër të një hetimi për vrasjen e rëndë të një zyrtari të UNMIK-ut dhe një polici të Kosovës, si dhe për një tentimvrasje të rëndë të dy zyrtarëve të tjerë të UNMIK-ut në vitin 2004. Gjatë këtij operacioni janë arrestuar katër persona.

Ngritja e kapaciteteve

Më 20 prill, EULEX-i ishte nikoqir i një konference të organizuar me Zyrën e Policisë Evropiane (Europol), e cila ka pasur për qëllim identifikimin e mundësive për bashkëpunim në luftën kundër trafikimit të armëve. Në konferencë kanë marrë pjesë zyrtarët e lartë të Policisë së Kosovës dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare. Ky ka qenë seminari i parë i policisë në nivel të ekzekutivit i mbajtur në Kosovë për prodhimin, posedimin dhe trafikimin e paligjshëm të armëve të lehta.

Më datat 2 dhe 3 qershor, është mbajtur një konferencë dy-ditore dhe një sesion trajnimi për rritjen e kapaciteteve të 37 prokurorëve të Kosovës në fushën e korrupsionit dhe të konfiskimit të aseteve.

Instituti i Mjekësisë Ligjore

Ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it në Institutin e Kosovës për Mjekësi Ligjore kanë vazhduar punën në përfundimin e raporteve të autopsisë dhe të ekzaminimit klinik. Ata gjithashtu ofruan përkrahje dhe ndihmesë institucioneve vendore lidhur me aktet nënligjore të Ligjit për mjekësinë ligjore. Më 20 qershor, ekspertët e mjekësisë ligjore të EULEX-it përfunduan vlerësimin e vendit në Kizhevak që ndodhet në kompleksin e minierave të Rudnicës në Serbi, i cili zgjati 140 ditë dhe nuk rezultoi me ndonjë gjetje. Dy mjekë vendorë me sukses përfunduan një kurs në internet nga fusha e antropologjisë së mjekësisë ligjore, të organizuar nga EULEX-i.

Të drejtat pronësore

Paneli i apelit i Agjencisë Kosovare të Pronës ka pranuar katër ankesa të reja dhe ka marrë vendim për 45 ankesa, ndërsa 281 ankesa presin vendimin e panelit.

Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme për çështje të privatizimit ka marrë 402 vendime në gjykimet e shkallës së parë dhe ka finalizuar 73 raste në nivel të panelit të apelit.

2.2 Fuqizimi

EULEX-i vazhdoi me monitorimin e seancave dëgjimore në disa raste që i janë bartur autoriteteve vendore. Po ashtu, ka bërë vlerësimin e regjistrave gjyqësorë në bazë të rregullave dhe standardeve në fuqi. Përveç kësaj, janë realizuar intervistat me shefat e zyrave për menaxhimin e rasteve të gjashtë gjykatave themelore dhe janë vizituar objektet. Menaxhimi koherent i rasteve është parakusht për sistem efikas dhe të efektshëm të drejtësisë. Problemet më urgjente të identifikuar ishin mungesa e stafit, mungesa e hapësirës për arkivim dhe mosrespektimi i duhur i rregulloreve dhe urdhëresave ekzistuese. Derisa në disa raste ky mosrespektim vjen si rrjedhojë e mungesës së parakushteve minimale (stafit, zyrave, hapësirës për arkivim, etj.), në rastet e tjera vjen nga mungesa e vetëdijesimit që çon në devijim nga zbatimi i rregulloreve mjaftueshmërisht të detajizuara nga zyrat e ndryshme për menaxhimin e rasteve.

Përzgjedhja në bazë të meritave e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve vazhdon të jetë sfidë. Më 22 dhe 23 prill, Këshilli Gjyqësor i Kosovës përsëriti testin me shkrim për zgjedhjen e 61 gjyqtarëve të gjykatave themelore, duke iu përmbajtur kësaj radhe rreptësisht të rregullave dhe rregulloreve. Testi është organizuar

vetëm për 75 kandidatët që fillimisht kaluan testin e kualifikimit para se Këshillit Gjyqësor i Kosovës vendosi të ulte prapun në mes të procesit të rekrutimit në tetor të vitit 2016. Si reagim ndaj kritikave të shumta të bashkësisë ndërkombëtare, duke përfshirë EULEX-in, Këshilli kishte vendosur që ta kthej prapa procesin e rekrutimit në fazën ku është mbajtur testi i kualifikimit. Gjatë muajit maj, janë intervistuar 78 kandidatë, dhe më 6 qershor, Këshilli publikoi rezultatet e konkursit. Pesëdhjetë e pesë kandidatë arritën numrin e nevojshëm të pikëve, dhe 54 janë duke pritur emërimin nga kryetari i Kosovës (një kandidat u tërhoq për shkak të arsyeve shëndetësore).

Më 12 qershor Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshëm vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme pas ankesës së parashtruar nga njëri prej kandidatëve të pazgjedhur, dhe urdhëroi Këshillin që të realizojë procesin e ri të votimit në përputhje me gjetjet e saj. Në përgjigjen e tij, Komisioni normativ i Këshillit Gjyqësor të Kosovës hartoi amendamentet në Rregulloren për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatës. Në përkrahje të mendimit se zgjedhja e kandidatëve në pozitë më të larta gjyqësore duhet të bazohet në parimet e barazisë, meritës dhe transparencës për të siguruar besimin e qytetarëve në gjyqësor dhe prokurori, i janë dërguar dy letra nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, Shefi i Misionit të EULEX-it dhe ambasadorët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës kryesuesit të Këshillit Gjyqësor, para vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe pas marrjes së vendimit të saj. Në kuadër të këtij konteksti, EULEX-i rekomandoi përfshirjen e amendamenteve më të gjëra dhe shtyrjen e miratimit të çfarëdo amendamenti deri në shpalljen e aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese lidhur me rastin e pazgjidhur të zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Apelit. Në përputhje me të, Këshilli u pajtua që të shtyj marrjen e çfarëdo vendimi.

Trajtimi preferencial i të burgosurve të nivelit të lartë gjatë caktimit të kushteve të mbajtjes në burg për një grup të përzgjedhur të të burgosurve mbetet çështje për t'u brengosur. Kjo manifestohet përmes pezullimit të dënimeve për shkaqe mjekësore, vizitave të shpeshta në spitale dhe zvogëlimin të nivelit të rrezikshmërisë të të burgosurve nga "i lartë" në "i mesëm" që përjashton masat shtesë të sigurisë; kjo përkundër këshillave eksplicite të EULEX-it.

Më 16 maj, Ministri i Drejtësisë për arsye mjekësore zgjati pezullimin e dënimit të një të burgosuri të profilit të lartë, i cili ishte dënuar në 15 vite burg, deri sa amendamentet e Ligjit të ri për ekzekutimin e sanksioneve penale hyn në fuqi më 26 maj. Ai i burgosur fare nuk u kthye në burg. EULEX-i mbajti disa takime me Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke përfshirë edhe një takim me kryetarin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës — gjykatës kompetente sipas Ligjit të ri për ekzekutimin e sanksioneve penale — ku iu kërkua këtij Shërbimi që të veproj. Më 15 qershor, Shërbimi Korrektues lëshoi një urdhërarrest që rezultoi me kthimin e të burgosurit në burgun e Dubravës në të njëjtën ditë. Më 3 korrik, me ftesë të kryetarit të Gjykatës Themelore të Vushtrrisë, e cila aktualisht kryen punët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, EULEX-i filloi monitorimin e sesioneve të Gjykatës lidhur me këtë rast.

Themelimi i Qendrës për Vlerësim të Shërbimit Korrektues të Kosovës, që është përgjegjëse për kategorizimin e duhur dhe planifikimin e dënimeve të të burgosurve, është duke përparuar me hapa të sigurt me përkrahjen e projektit të financuar nga EULEX-i. Në maj dhe qershor, trajnimi është fokusuar në konceptet e përgjithshme të vlerësimit dhe janë bërë edhe vlerësimet e rrezikut, duke përfshirë edhe vizitat studimore të stafit vlerësues dhe menaxherëve të lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës në qendrat e vlerësimit në Finlandë e Suedi. Megjithëkëtë, mungesa e programeve të rehabilitimit vazhdon të paraqet sfida në planifikimin e duhur e dënimeve dhe zbatimin e tyre.

Më 13 qershor, Komisioni përgjegjës për zgjedhjen e drejtorit të ri të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës futi në listën e ngushtë për intervistë katër kandidatë. Intervistat janë mbajtur më 27 dhe 28 qershor, por të njëjtat rezultuan me një proces jotransparent nga fakti se më pak se tre kandidatë morën pjesë në intervista. Më vonë ishte intervistuar një kandidat që fillimisht kishte njoftuar se nuk do të merr pjesë. Asnjëri prej kandidatëve nuk arriti pragun e nevojshëm për përzgjedhje. Më 3 korrik, Ministria e Drejtësisë zyrtarisht e anuloi procesin. EULEX-i ka shqetësime serioze për procesin e përzgjedhjes. Andaj, si rezultat i shqetësimeve për kushtet e kualifikimit, rekomandon fuqimisht rishikimin e kriterëve të përzgjedhjes para rishpalljes së konkursit.

Më 19 prill, autoritetet e Kosovës kanë shpallur një strategji dhe plan veprimi për mbrojtje nga dhuna familjare, e cila mbulon periudhën prej vitit 2016 deri më 2020. Në procesin e hartimit të saj ka kontribuar edhe EULEX-i. Në ceremoninë e shpalljes së Strategjisë, Ministria e Drejtësisë e paraqiti Strategjinë dhe njoftoi se është emëruar koordinatori i ri nacional kundër dhunës në familje. Ky është një hap i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje dhe asaj gjinore.

Në maj, EULEX-i finalizoi vlerësimin e planit strategjik zhvillimor të Policisë së Kosovës për periudhën 2016-2020. Këtë plan ia dha edhe drejtorit të përgjithshëm të Policisë, i cili do ta përdorë për nxitjen e përmirësimeve të mëtejshme në fusha të caktuara. EULEX-i ka analizuar planet vjetore të drejtorisë regjionale të Policisë për vitet 2016 dhe 2017 lidhur me cilësinë dhe respektimin e planit strategjik zhvillimor dhe të planeve vjetore të Policisë së Kosovës në nivel qendror për vitet 2016 dhe 2017. Derisa planet e policisë në nivel qendror paraqesin instrumentet e duhura për përmirësimin e punës së policisë, një vlerësim i planeve vjetore të drejtorive regjionale të policisë tregoi se zbatimi në nivel regjional shpesh nuk është i duhur, i mungojnë hollësitë dhe qasja e përbashkët standarde.

Si reagim ndaj sulmeve të përsëritura dhe incidenteve të mundshme etnikisht të motivuara në Veri të Mitrovicës që nga fillimi i vitit, EULEX-i ka mentoruar Drejtorinë regjionale të Policisë së Kosovës në veri të Mitrovicës lidhur me hetimet aktuale, duke e këshilluar për mundësitë e hetimit proaktiv dhe për aktivitetet parandaluese. Gjithashtu, lehtësoi bashkërendimin dhe bashkëpunimin operacional mes Policisë në veri dhe në jug të Mitrovicës. Në të dyja anët EULEX-i vërejtí interesim të dukshëm për bashkëpunim të efektshëm.

Së bashku me Policinë e Kosovës, e cila në cilësinë e reaguesit të parë të sigurisë në ditën e zgjedhjeve parlamentare më 11 qershor angazhoi për afërsisht 6,000 pjesëtarë, EULEX-i dhe KFOR-i kanë përmbushur rolet e tyre përkatëse në cilësinë e reaguesit të dytë dhe të tretë të sigurisë. Me kërkesë të Policisë së Kosovës për të siguruar dukshmëri të lartë dhe për të vepruar si reagues i dytë i sigurisë në Leposaviq në rast nevojë, EULEX-i ka dërguar një togë të policisë në atë zonë, ndërsa dy togë shtesë kanë qenë në gjendje gatishmërie në bazën logjistike të Mitrovicës. Brenda kornizës së zgjedhjeve, EULEX-i ofroi misionit të Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve siguri, duke përfshirë mbrojtje nga afër në veri, dhe njoftim për gjendjen e sigurisë, si dhe përkrahje logjistike e administrative. Misioni vëzhgues gjithashtu i ofroi përkrahje logjistike, siç janë pajisjet dhe automjetet, dhe njoftim të kufizuar për situatën punonjësve të OSBE-së të dërguar në veri.

Misioni ka këshilluar autoritetet e Kosovës për çështje të policimit në nivel strategjik para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve. Gjatë fazës parazgjedhore, EULEX-i ka intensifikuar monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e Policisë së Kosovës dhe ka mbajtur takime të përditshme me ekipet e komandës së stacioneve në stacionet policore në Graçanicë dhe Leposaviq, duke vlerësuar gjendjen e sigurisë dhe incidentet e mundshme të ndërlydhura me zgjedhjet. Përveç kësaj, është angazhuar edhe në vlerësimin fillestar të 33 incidenteve të ndërlydhura me zgjedhjet, të regjistruara nga Policia e Kosovës dhe ka bërë aktivitetet e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit për 21 prej tyre.

Më 28 qershor, 1,500 pjesëmarrës, duke përfshirë politikanë serbë, u mbledhën në manastirin e Graçanicës dhe në Gazimestan për festimin vjetor të Vidovdanit. EULEX-i ka këshilluar Policinë e Kosovës gjatë zhvillimit dhe realizimit të planit të saj operacional, duke vlerësuar punën e policisë si profesionale dhe të planifikuar mirë. Festimi ka kaluar pa ndonjë incident të sigurisë. Si rrjedhojë e kacakfytyjeve dhe incidenteve të sigurisë lidhur me festimet e ditës së Vidovdanit në vitin 2012, Policia e Kosovës vazhdimisht ka përmirësuar operacionet e saj, duke kulminuar me punën e saj profesionale në vitin 2017.

Pas një vizite studimore në Mbretërinë e Bashkuar të një delegacioni të lartë nga Kosova në muajin mars, të organizuar nga EULEX-i në partneritet me Zyrën për Ndërlidhje Ndërkombëtare të Doganave në Mbretërinë e Bashkuar dhe me Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës — autoritet e Kosovës krijuan një grup punues për shqyrtimin e Qendrës Nacionale për Menaxhim të Kufijve. Objektivi i Qendrës është që Kosovës t'i ofrohen kapacitete teknike për grupim, analizë dhe shpërndarje të informatave, si dhe ndihmesa për agjencitë kufitare në luftimin e korrupsionit dhe të krimit të organizuar ndërkufitar.

Rishikimi vjetor i planit të integruar për menaxhimin e kufirit është kryer dhe finalizuar në qershor në kuadër të një punëtorie të organizuar në Tiranë, me financim të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, para se t'i paraqitej për miratim bordit ekzekutiv për menaxhimin e integruar të kufirit. Si një anëtar zyrtar i grupit punues përgjegjës për përditësimin e planit, EULEX-i ka parashtruar komentet në draftin përfundimtar të dokumentit.

Pas vendimeve të arritura brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja lidhur me zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes të vitit 2011, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, në konsultim me ministren për Dialog, ka hartuar dy udhëzime administrative – njëri lidhur me zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së targave KS dhe tjetri për dokumentet dhe dëshmitë specifike të nevojshme për qytetarët për ta dëshmuar identitetin e tyre. Të dyja i janë dorëzuar ministrit të Punëve të Brendshme dhe janë duke pritur nënshkrimin e tij.

Më 21 prill, është bërë një hap i madh përpara kur në bazë të rekomandimeve të EULEX-it, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës vendosi të lejoj regjistrimin për 1,239 automjete me targa RKS dhe KS të lëshuara nga autoritetet e Kosovës pa pasur nevojë që pronarët të paguajnë doganën. Këto automjete që nga tetori i vitit 2012 kanë pasur targat e përkohshme të regjistrimit.

Përparim i caktuar gjithashtu është bërë lidhur me zbatimin e regjimit të ngjitëseve, për të cilin është arritur pajtimi në shtator 2016, për mbulimin e akronimeve “RKS” dhe “SRB” dhe të stemës në targat me ngjitëse të bardha. Megjithatë, si rezultat i procedurës së tejzgjatur të tenderimit për furnizuesin e ngjitëseve ende ka vonesa në këtë drejtim.

3. Çështjet e tjera kryesore

Asgjë e rëndësishme për raportim.

Shtojca

II

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Pas dërgimit të rregullores së punës dhe të dëshmive të Dhomave tek Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese më 27 mars, Dhoma e Specializuar ka nxjerrë aktgjykimin e parë më 26 prill, dhe pastaj pas rishikimit të disa dispozitave nga kolegji i gjyqtarëve, aktgjykimi i formës së prerë është nxjerrë më 28 qershor, ku njëzëri është vendosur që rregullorja e ndryshuar nuk është në mospërputhje me kapitullin II të Kushtetutës përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore. Kryetari i Dhomave të Specializuara, theksoi se vendimi i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese garanton që rregullorja zbaton standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe se rregullorja siguron një sistem të plotë të mbrojtjes së individëve, të cilët mund të jenë në rrezik si pasojë e pjesëmarrjes së tyre në procedurat para dhomave të specializuara. Më 5 korrik, ka hyrë në fuqi rregullorja e punës dhe e dëshmive. Dhomat e Specializuara tani janë plotësisht operationale nga aspekti juridik dhe nuk ka pengesa ligjore për pranimin e çfarëdo parashtrere apo aktakuze.

Shtojca

III

Përbërja dhe numri i komponentit të policisë së Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë


(deri më datën 15 korrik 2017)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Austria	1
Bullgaria	1
Finlanda	1
Gjermania	1
Hungaria	2
Federata Ruse	1
Turqia	1
Gjithsej	8

Përbërja dhe numri i komponentit për ndërlidhje ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

(deri më datën 15 korrik 2017)

<i>Shteti</i>	<i>Numri</i>
Çekia	2
Polonia	1
Republika e Moldavisë	1
Rumania	1
Turqia	1
Ukraina	2
Gjithsej	8



Map No. 4133 Rev. 71 UNITED NATIONS
July 2017

Department of Field Support
Geospatial Information Section (formerly Cartographic Section)